

Statistikat tregtare Kosovë – Serbi, 2015 -2024


Oda Ekonomike e Kosovës

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për periudhën janar-dhjetor 2024, deficitit tregtar ka shënuar një rënie prej 46.5% krahasuar me vitin 2023, duke arritur vlerën prej -76.5 milionë euro nga -143.0 milionë euro një vit më parë. Mbulueshmëria e importeve nga eksportet ka arritur në 41.1%.

Gjatë periudhës 2021-2024, eksportet kanë ndjekur një trend rritës mesatar prej 52.4 milionë euro në vit (18.3% vjetor), ndërsa importet janë rritur mesatarisht me 249.8 milionë euro (4.1% vjetor). Deficitit tregtar me Serbinë ka regjistruar një mesatare vjetore prej 197.3 milionë euro.

Në vitin 2024, eksportet drejt Serbisë kanë arritur në 53.3 milionë euro, duke përbërë 5.7% të totalit të eksporteve (mesatarja vjetore 2021-2024: 6.0%). Ndërkohë, importet nga Serbia kanë shënuar 129.7 milionë euro, përkatësisht 2.0% të importeve totale (mesatarja vjetore 2021-2024: 4.7%).


Bilanci tregtar i mallrave me Serbinë në mil.Euro




Sipas të dhënave nga Open DATA - Doganat e Kosovës, eksportet e vendit për vitin 2024 dominohen nga disa kategori kryesore të mallrave. Metalet bazë dhe artikujt prej tyre përbëjnë 32.8% të totalit të eksporteve, pasuar nga produktet vegjetale me 12.5% dhe plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre me 11.8%.

Nga ana tjetër, struktura e importeve tregon një përqendrim të lartë në disa grupe kryesore produktesh. Produktet vegjetale përbëjnë 24.1% të importeve totale, të ndjekura nga ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani me 17.5%, si dhe metalet bazë dhe artikujt prej tyre me 17.0%.

Eksportet 2024 sipas Sekcioneve-grup kapitujve, në %



Importet 2024 sipas Sekcioneve-grup kapitujve, në %



Përgatitur nga: Oda Ekonomike e Kosovës, Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org